

Muhammed ibn Salih El-Uthejmin

**Rregullat e
agjërimit, teravive
dhe zekatul-fitrit**

KAPITULLI I

NORMA PËR AGJËRIMIN

Agjërimi i muajit Ramazan është detyrë e obligueshme (farz) sipas Kur'anit, Sunnetit të Pejgamberit, mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, dhe pajtimit (ixhmasë) së muslimanëve. Allahu në Kur'an thotë:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse, që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.

(jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë.

E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për te. Mirëpo, po që se dini, agjërimi është më i mirë për ju.

(Ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramazanit që në të (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqaruesi i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtër). E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (të agjëroni ditët e lëshuara më vonë)

Që të plotësoni numrin, të madhëroni Allahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni.

E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua."
[el- Bekare : 183 -186]

Pejgamberi Muhammed, mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Islami qëndron mbi pesë shtylla: Të dëshmuarit se askush nuk duhet të adhurohet, përveç Allahut dhe se Muhammedi është dërguar i Allahut, kryerja e namazeve, dhënia e Zekatit, kryerja e haxhit në Mekke dhe agjërimi i*

muajit Ramazan." [Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi]

Është konsensus i muslimanëve se agjërimi i muajit Ramazan është detyrë e obligueshme në Islam (farz). Prandaj, kushdo që e mohon agjërimin e muajit Ramazan është kafir (jobesimtar), të cilit duhet dhënë mundësia për t'u penduar. Po që se ai pendohet dhe bindet se muaji Ramazan është farz, atëherë atë nuk duhet dënuar; përndryshe, atë duhet ekzekutuar si qafir.

Agjërimi i Ramazanit u urdhërua në vitin e dytë hixhri, ndërsa Pejgamberi Muhammed, mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, agjëroi nëntë ramazane.

Agjërimi i muajit të Ramazanit është detyrë e obligueshme për çdo musliman

të rritur dhe me arsye të shëndoshë. Agjërimi nuk është i obligueshëm për qafirin dhe nuk pranohet nga ai derisa të bëhet musliman. Agjërimi gjithashtu nuk kërkohet nga fëmijët, deri sa ata ta arrijnë pjekurinë.(e pjekuria arrihet nëpërmjet këtyre gjërave: plotësimit të 15 vjetëve, dalja e qimeve nën sqetulla, derdhja e spermës qoftë nëpërmjet ejakulimit në ëndërr apo ndonjë mënyrë tjetër dhe femrat ia shtojnë kësaj menstruacionet.)

Nga fëmijët mund të kërkojnë të agjërojnë po qe se mund ta bëjnë këtë pa i shkaktuar dëm vetvetes, ashtu që duke u rritur të mësohen me të.

Të çmendurit dhe personat e pavetëdijshtë nuk duhet të agjërojnë. Për këtë arsye, nga pleqtë në moshë të

shtyrë, të cilët nuk janë mendërisht të aftë, si dhe nuk mund ta bëjnë dallimin mes gjërave, nuk pritët të agjërojnë dhe nuk ka nevojë që të ofrojnë ushqim për mos agjërimin e tyre.

KAPITULLI II

DOBITË DHE URTËSITË NGA AGJËRIMI

Njëri nga emrat e Allahut të madhërishëm është edhe El-Hakim (i Urti). Urtësia është atribut i bërjes së gjërave në mënyrë të përsosur dhe në perspektivën e duhur të tyre. Prandaj, çdo gjë që krijoi Allahu, ose që na urdhëroi neve ta kryejmë duhet të jetë për shkak të një urtësie të lartë, të cilën ne ndoshta mundemi ose nuk mundemi tërësisht ta kuptojmë.

Agjërimi, ashtu siç është përshkruar nga Allahu, i ka dobitë vijuese:

Ai është një akt adhurimi, përmes të cilit muslimani përpiqet ta kënaqë Zotin

e tij duke abstenuar nga gjërat siç janë ushqimi, pirja dhe marrëdhëniet intime, në mënyrë që ta fitojë miratimin e Allahut dhe të fitojë botën tjetër. Në këtë mënyrë muslimani përmes vetëmohimit të vet tregon se, në vend të asaj që ai e pëlqen, e ka pëlqyer atë që e ka zgjedhur Allahu dhe se në vend të kësaj jete, ai e ka zgjedhur jetën e amshuar.

Një dobi tjetër është se agjërimi i kryer si duhet paraqet një rën nga arsyet që njeriun e bëjnë t'i frikësohet Allahut. Allahu thotë:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”

Agjëruesi duhet të jetë person që i frikësohet Allahut të Lartësuar, duke ju bindur urdhrave të Tij, si dhe duke u përmbajtur (abstenuar) nga gjërat, të cilave Ai na ka urdhëruar që t'u shmangemi. Ky është qëllimi përfundimtar i agjërimit. Nuk është qëllimi që të torturohet agjëruesi duke e ndaluar atë nga ngrënia, pirja apo marrëdhënia seksuale. Pejgamberi Muhammed, mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë:

“Allahu nuk ka nevojë për një person që përmbahet nga ngrënia dhe pirja, nëse personi i tillë nuk përmbahet nga gënjeshttrat, nga veprimi sipas tyre dhe shprehja e injorancës.” [Buhariu]

“Gënjimi” i përfshin të gjitha veprimet e ndaluara të fjalimit, si gënjeshtra, të

folurit pas shpine (Gibeti) dhe ofendimit të tjerëve.

"Të vepruarit sipas gënjeshtreve" përfshin të gjitha veprimet armiqësore ndaj të tjerëve përmes mashtrimit, rrahjes, tradhtisë ose vjedhjes. Kjo përfshin të dëgjuarit e gjërave të cilat nuk lejohen të dëgjohen, deri te dëgjimi i këngëve dhe instrumenteve të ndaluara.

"Injoranca" nënkupton sjelljen në mënyrë jo të arsyeshme përmes të folurit ose qëndrimit.

Po qe se një person agjëron në përputhje me ajetet Kuranore dhe me thëniet e Pejgamberit, mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, atëherë agjërimi i tij do ta shpjerë drejt vetë përmirësimit si dhe drejt përmirësimit

të moralit dhe sjelljes së tij, ndërsa ai do të vërejë se me përfundimin e Ramazanit, ka përparuar shumë në moralin e tij personal.

Një nga dobitë e agjërimit është ajo se personi i pasur është në gjendje ta çmojë bamirësinë e Allahut ndaj tij. Ai do ta njohë se Allahu e ka furnizuar atë me një qasje të lehtë dhe të lejuar ndaj gjërave, të cilat ai i dëshiron, siç janë ushqimi, pirja dhe marrëdhëniet intime. Personi i tillë duhet ta falënderojë Zotin e tij për dhuratat e Tij dhe t'i ketë ndërmend vëllezërit e tij të varfër, të cilët nuk i kanë këto gjëra. Prandaj, ai duhet të jetë bamirës ndaj tyre duke u ofruar ndihma (sadaka) dhe mirësjellje.

Një dobi tjetër e agjërimit është se ai e stërvitë agjëruesin që ta kontrollojë

veten e tij, në mënyrë që ta udhëheqë atë drejt vetë interesit dhe lumturisë së tij të vërtetë, si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër. Ai do ta ruante veten nga të jetuarit si një kafshë, e cila nuk mund ta ruajë veten nga dëshirat dhe epshet e saj.

Dobitë e tjera të agjërimit i përfshijnë dobitë shëndetësore, të cilat rezultojnë nga pakësimi i ushqimit të futur në trup dhe nga mos ngarkimi i sistemit të tretjes.

KAPITULLI III

AGJËRIMI I UDHËTARIT DHE TË SËMURIT

Përkitazi me agjërimin e personit të sëmurë apo udhëtarit, Allahu thotë:

"... e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë."

Ekzistojnë dy lloje të sëmurësh:

Llojit të parë i takon personi, sëmundja e të cilit është e vazhdueshme dhe nga i cili nuk pritet që të shërohet (siç është personi që vuan nga kanceri).

Personi i tillë, i sëmurë nuk duhet të agjërojë, për shkak se ai nuk mundet në asnjë kohë ta durojë agjërimin. Sido

qoftë, ai duhet t'u ofrojë ushqim të varfërve për çdo ditë që e lë pa agjëruar. Në këtë drejtim, ai mund t'i tubojë një grup të varfërish, të barabartë me numrin e ditëve që i ka lënë pa agjëruar, dhe atyre t'u ofrojë drekë ose darkë, siç vepronte Enes ibn Maliku kur u plak. Ose, mund t'i shpërndaj ushqim një grupi personave të varfër, të barabartë me numrin e ditëve të pa agjëruara. Çdo personi të varfër duhet dhënë një çerek te "sa'asë së Pejgamberit", që është një sasi e ushqimit e barabartë me pesëqind e dhjetë gramë grurë të mirë. Është e preferuar që kësaj sasive t'i shtohet sasia e duhur e mishit apo vajit, e nevojshme për gatim.

Ngjashëm personi në moshë të shtyrë, i cili nuk është në gjendje të agjërojë, duhet t'i ofrojë ushqim një të varfëri për çdo ditë që e ka lënë pa agjëruar.

Llojit të dytë i takon personi që është përkohësisht i sëmurë (p.sh. personi në ethe), ndërsa në këtë rast kemi tri kategori:

KATEGORIA E PARË:

Ai vëren që agjërimi për të nuk është i vështirë dhe i dëmshëm. Në këtë rast duhet të agjërojë për shkak se nuk ka kurrfarë arsytimi për mos ta bërë këtë.

KATEGORIA E DYTË:

Ai e sheh se agjërimi për të është i vështirë, por jo edhe i dëmshëm. Në këtë rast agjërimi për të nuk është i këshillueshëm për të, për shkak se është më mirë që ai ta shfrytëzojë lejen e Allahut, pasi që agjërimi do të ishte i vështirë për të.

KATEGORIA E TRETË:

Agjërimi do të ishte i dëmshëm për të. Në këtë rast agjërimi është i ndaluar (haram), për shkak se Allahu thotë:
“As mos e vrisni (ose shkatërmoni) vetveten, për shkak se vërtetë Allahu

ka qenë shumë i Mëshirueshëm ndaj jush"

, dhe ka thënë:

"Dhe mos bëni që me duart tuaja ta shkatërroni vetveten."

Ndërsa në një hadith, Pejgamberi Muhammed ,mëshira dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë:

"Mos dëmtoni (vetveten) e as mos dëmtoni (të tjerët)." [Transmetuar nga Ibn Maxhe dhe Hakimi]

En-Neveviu thotë se ekzistojnë edhe shënime të tjera të ngjashme që e forcojnë njëri tjetrin.

Dëmi i agjërimit mbi një njeri të sëmurë mund të verifikohet si nga vetë i sëmuri, ashtu edhe nga ndonjë mjek i besueshëm. Kështu, po qe se një njeri i kësaj kategorie e ndërpret agjërimitin e

tij, ai duhet t'i agjërojë ato ditë menjëherë posa ta marrë veten (të shërohet). Mirëpo, po qe se vdes para se të shërohet, atëherë obligimi lihet, për shkak se ai ka pasur për qëllim që t'i plotësoj ato ditët e lëna me ditët të cilat nuk arriti t'i jetojë.

Për sa u përket udhëtarëve, ekzistojnë dy lloj syresh: njeri, i cili përpiqet t'i shmange agjërimin duke u nisur për udhëtim. Kjo nuk i është i lejuar atij, për shkak se mashtrimi për shmangien e një detyre të obligueshme të Allahut, nuk e eliminon vetë atë detyrë. Për sa i përket llojit të dytë(udhëtarit të vërtetë), ekzistojnë dy grupe:

GRUPI I PARË:

Udhëtari i cili përjeton vështirësi të jashtëzakonshme. Në rastin e tillë agjërimi është haram (i ndaluar), për shkak se Pejgamberi Muhamed, mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, që ishte duke agjëruar gjatë luftës për çlirimin e Mekës, kur kuptoi së disa njerëz që ishin me të përjetonin vështirësi të mëdha nga agjërimi, ndërsa ishin duke e bërë pikërisht atë që e bënte edhe ai, e piu një kupë me ujë, pas namazit të ikindisë, kur njerëzit ishin duke e shikuar. Në atë rast i treguar se disa njerëz ende agjëronin. Atëherë, ai tha:

"Ata janë mos bindësit, ata janë mos bindësit." [Transmetuar nga Muslimi]

GRUPI I DYTË:

Ky lloj udhëtari e gjen agjërimin të vështirë, por jo jashtë mase. Është e preferuar që udhëtari i tillë mos të agjëroj, për shkak se, me vetë agjërimin, ai do ta refuzonte lejimin e Allahut e gjithashtu do t'i shkaktonte vështirësi dhe vuajtje vetvetes.

GRUPI I TRETE:

Këtu udhëtari nuk e gjen agjërimin të vështirë. Udhëtari i tillë duhet ta bëjë atë që është më e lehtë për të (d.m.th., ai zgjedh mes agjërimit dhe mos agjërimit), për shkak se Allahu thotë:
“Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju.”

Me 'dëshiron", në këtë rast nënkuptohen "i pëlqen". Po që se për një udhëtar të tillë agjërimi dhe mos agjërimi janë të barabartë, atëherë agjërimi është i preferuar, për shkak se kështu vepronte edhe Pejgamberi Muhammed.

Në Sahih-Muslim, është shënuar se Ebu Derda (Allahu qoftë i kënaqur me të), ka thënë:

"Udhëtonim me Pejgamberin ,mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, në Ramazan, në kushte aq të nxehta sa që i venim duart mbi kokë për shkak të nxehtësisë, ndërsa të vetmit që agjëronin në mesin tonë ishin i Dërguari i Allahut dhe Abdullah ibn Revaha."

Udhëtari konsiderohet se është në udhëtim që nga çasti kur e braktisë

qytetin (vendin) e vet e derisa të kthehet prapë, madje edhe po qe se ai qëndron në qytetin e destinacionit për një periudhë të caktuar kohore, nëse qëllimi i tij është që mos të mbetet në të pasi ta kryejë atë për çka ka udhëtuar.

Në këtë rast ai i shfrytëzon lejimet e dhëna për udhëtarin, madje edhe nëse qëndrimi vazhdon për një kohë të gjatë, për shkak se kurrfarë veçantish nuk janë shënuar nga Pejgamberi Muhammed mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, lidhur me periudhën kohore që e përcakton udhëtimin. Kushti themelorë është që udhëtimi dhe rregullat që kanë të bëjnë me të, të mbeten të vlefshme derisa të ketë dëshmi se udhëtimi i tillë ka përfunduar,

ose se janë shfuqizuar rregullat që kanë të bëjnë me të.

Nuk ekziston kurrfarë dallimi ndërmjet udhëtimeve (me lejimet e bashkangjitura) që janë të rëndësishme, si ato të Haxhit apo të Umrës, ose vizitat e ndonjë kushëririt ose tregtia e të ngjashme dhe atyre të bëra me shoferët e taksive apo të kamionëve. Shoferët e tillë konsiderohen si udhëtarë që nga çasti kur e braktisin vendbanimin e tyre, ndërsa mund t'i gëzojnë të gjitha lëshimet e lejueshme për udhëtarët e tyre, siç janë mos agjërimi në Ramazan, shkurtimi i namazeve prej katër rekatesh, bashkimi i dy namazeve kur është e nevojshme (njëri menjëherë pas tjetrit), siç janë Dreka e ikindija, dhe akshami e jacia.

Mos agjërimi preferohet për personat e tillë nëse ai paraqet zgjidhjen më të lehtë, ndërsa këtë ata e përmbushin në dimër. Kjo është kështu për shkak se shoferët e tillë i takojnë një qyteti të veçantë dhe kur menjëherë janë në qytetet e tyre, ata konsiderohen si banorë ndërsa rregullat që vlejnë për banorët janë të zbatueshme edhe për ta. Në të kundërt, kur ata janë në udhëtim atëherë konsiderohen si udhëtarë dhe rregullat që vlejnë për udhëtarët janë të zbatueshme edhe për ta.

KAPITULLI IV

GJËRAT QË E PRISHIN AGJËRIMIN

Ekzistojnë shtatë gjëra që e prishin agjërimin:

1. Marrëdhënia seksuale: Kur një agjëruer ka marrëdhënie seksuale agjërimi i tij priset. Po qe se ai është njëri nga personat, nga të cilët kërkohet të agjërojnë, ndërsa marrëdhënia seksuale ka ndodhë gjatë ditës, atëherë do të obligohet të shpaguej për këtë. Në rastin e këtillë shpagimi do të ishte njëra nga gjërat vijuese përkatësisht: e para është lirimi i një robi; po qe se kjo nuk është e mundshme, atëherë ai duhet të agjërojë dy muaj pa ndërprerje. Nëse

nuk mund ta bëjë këtë, atëherë ai duhet t'i ushqejë gjashtëdhjetë persona të varfër.

Mirëpo, po që se personi që agjëron nuk është njëri nga ata që duhet të agjërojnë, (p.sh. Udhëtari), ndërsa ka pasur marrëdhënie seksuale, atëherë nga ia kërkohet përmbushja (kaza) e jo shpagimi (kefare).

2. Derdhja e spermës përmes prekjes, puthjes ose përqaqimit. Puthja pa derdhje nuk e prish agjërimin.

3. Marrja e çfarëdo lloj ushqimi apo pirje që arrin deri në bark ose përmes gojës ose përmes hundës.

Është e ndaluar për personin që agjëron të thithë tymin e 'Behurit' (lloj druri që

kur të digjet, tymi i saj shndërrohet në erë të mirë) që arrin deri në bark, ngase tymi i saj është si trupthi. Marrja erë parfumeve është lejuar.

4. Çdo gjë që i ngjan ngrënies ose pirjes. Për shembull, çfarëdo injeksioni vitaminoz që vepron si ushqim. Përndryshe, injeksionet tjera lejohen gjate agjërimit.

5. Nxjerrja e gjakut përmes 'hixhames' ose nëpërmjet venave, kur kjo shkakton plogështinë e trupit. Nxjerrja e sasisë së vogël të gjakut është e lejuar ngase nuk ndikon në plogështinë e trupit sikur hixhameja.

6. Vjellja e qëllimtë.

7. Paraqitja e të përmuajshmeve (menstruacioneve), ose gjakderdhja pas lindjes.

Efektet e shtate gjërave të lartpërmendurave u nënshtrohen tre kushteve vijuese.

KUSHTI I PARË:

Personi që agjëron duhet të jetë i vetëdijshëm për rregullin në atë kohë. Prandaj, nëse një person kryen 'hixhamen' gjatë agjërimit, duke qenë i bindur që kjo nuk e prish agjërimin e tij, atëherë agjërimi i tij nuk do të priset, për shkak se ai nuk i di rregullat. Allahu thotë: **“Nuk është ndonjë mëkat juaji ajo për çka keni gabuar, por (është mëkat) ajo që zemrat tuaj e bëjnë qëllimisht”** [Ahzab: 5] dhe ka thënë:

"Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë! [Bekare: 286] e Allahu thotë: "e kam bërë këtë"

*Si dhe transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Adij ibn Hatimi, i cili kishte vendosur dy penj, një të zi dhe një të bardhë nën jastëkun e tij. Ai filloi të hante përderisa arriti t'i dallonte ata njërin nga tjetri, e atëherë ai u përmbajt nga ushqimi duke menduar se kjo që bëri ishte qëllimi i fjalës së Allahut: **"derisa qartë të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim."** [Bekare:18] *lajmëroi Pejgamberin e Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, për veprimin e tij e ai i tha : "Jo është për qëllim bardhësia e ditës dhe errësira e natës"**

Njësoj, po qe se personi që agjëron merr ushqim pas agimit, por se ende nuk ka aguar dielli, agjërimi i tij nuk do të priset për shkak se ai nuk e di kohën e saktë.

Esmā, e bija e Ebu Bekrit, ka thënë: “Në një ditë me mjegull, kemi bërë iftar në kohë të Pejgamberit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, e pastaj doli dielli.” [Transmeton Buhariu] E po të ishte obligim agjërimi i një ditë tjetër do të sqaronte Pejgamberi ,paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, sepse Allahu plotësoi me të fenë, e po të sqarohej do ta transmetonin atë Sahabet ,ngase Allahu e ka marrë përsipër ruajtjen e fesë, dhe mos transmetimi i sahabëve tregon se nuk është obligim si dhe këto lajme me

siguri do të transmetoheshin për shkak të rëndësisë së tyre dhe nuk do të anashkaloheshin.

KUSHTI I DYTË:

Të kujtuarit e agjërimit. Kështu që nëse një person që agjëron merr ushqim duke harruar se është duke agjëruar, agjërimi i tij nuk do të prishet. Pejgamberi, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, thotë: *“Ai që nga harresa han dhe pinë duke qenë agjërueshëm le ta plotëson agjërimin e tij, ngase atë e ka ushqyer dhe i ka dhënë të pijë Allahu”*. [Transmeton Buhariu dhe Muslimi]

KUSHTI I TRETË:

Personi që agjëron ka vullnetin e tij të lirë. Po qe se detyrohet të hajë apo të pijë, agjërimi i tij nuk do të priset.

Ngjashëm, po qe se ai duke e shpërlarë gojë me gargarë, ose duke hedhur ilaç me pika ne sytë e tij, disa pika të ujit ose të ilaçit arrijnë pa qëllim deri te barku i tij, agjërimi i tij nuk do të priset ngase kjo është pa dëshirën e tij.

Vlen të shënohet se përdorimi i 'Sivakut' për pastrimin e dhëmbëve nuk e prish agjërimin. Përkundrazi, është sunnet të pastrohen dhëmbët për të dhe për të tjerët në çdo kohë gjatë ditës.

Personi që agjëron i lejohet të bëj çka do që i pakëson telashet për shkak të

vapës dhe etjes, siç është përdorimi i ujit për ta flladitur trupin. Pejgamberi Muhammed, mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, derdhte ujë mbi kokën e vet derisa agjëronte. [Transmeton Ebu Davudi] Ibn Umeri e lagte një copë rrobe dhe e vente mbi trupin e vet.[Transmeton Buhariu] Gjërat e këtilla janë lehtësime, të cilat Allahu na ka lejuar ti gëzojmë.

KAPITULLI V

Teravitë

Teravitë: janë falja e namazit të natës me xhemat në Ramazan. Koha për të është që pas namazit të Jacisë e deri në namazin e Sabahut. I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka nxitur në faljen e namazit të natës ku dhe thotë: *“Ai që e falë Ramazanin me besim dhe llogarit shpërblimin do t’i falen mëkatet e mëparshme”*. Buhariu transmeton nga Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të) se Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) është falur një natë në xhami dhe me të janë falur disa njerëz. Pastaj është falur edhe të

nesërmen dhe njerëzit janë shtuar. Natën e tretë apo katërt u mbledhën por, ai nuk iu doli atyre e në mëngjes iu tha: *“Ju kam parë se u mbledhët dhe nuk më ma penguar të dal vetëm se frika se mos po iu obligohet juve.”* Dhe kjo në Ramazan.

Synet është të përkufizohet në njëmbëdhjetë rekate ku jep selam pas çdo dy rekateve, ngase Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të) është pyetur: *“Si ishte namazi i Pejgamberit (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) në Ramazan? Ajo ka thënë: “Nuk ka shtuar në Ramazan e as jashtë tij me tepër se njëmbëdhjetë rekate.”* (Buhariu dhe Muslimi)

Në Muveta transmetohet nga Muhamed b. Jusufi (e ai është i

besueshëm) e ai nga Saib b. Jezid (e ai është sahabij): *“Se Omer b. Hattabi (Allahu qoftë i kënaqur me të) e ka urdhëruar Ubej b. Kabin dhe Temim Ed Darij që t’ua falin namazin e natës njerëzve nga njëmbëdhjetë rekate.”*

Edhe nëse shton më tepër se njëmbëdhjetë rekate nuk është problem, ngase Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) është pyetur për namazin e natës dhe ka thënë: *“Namazi i natës falet dy nga dy e kur dikush prej juve t’i frikësohet agimit le ta falë një rekat, të jetë tek i asaj që ka falur më herët.”* (Buhariu dhe Muslimi)

Por, kujdesi për numrin i cili është përmendur në synet duke i falë ngadalë dhe duke i zgjatur aq sa nuk iu vjen

njerëzve rëndë është më mirë dhe më e plotë.

Ndërsa shpejtimi i disa njerëzve gjatë faljes së tyre është në kundërshtim me atë që është e lejuar. E nëse shpejtimi shpion në mos kryerjen si duhet të ndonjë rukni(shtylle të namazit) apo vaxhibi, kjo e prishë namazin.

Shumë imamë nguten në namazin e teravive e kjo është gabim sepse, imami nuk falet vetëm për veten e tij por, edhe për të tjerët e ai i ngjan kujdestarit e për këtë duhet të bëjë atë që është më e mira. Dijetarët e kanë përmendur se për imamin është mekruh (e papëlqyer) të shpejton gjatë faljes sa që e pengon xhematin të veprojnë atë që është synet gjatë namazit. E si është puna e atij që

shpejton sa që i pengon xhematin të veprojnë atë që është vaxhib.

Njerëzit duhet të kujdesen për faljen e teravive dhe të mos i humbin ato duke u falur gjatë natës nga një xhami në tjetrën, ngase ai që falet me imamin derisa ta kryej namazin i shkruhet sikurse të jetë falë tërë natën edhe nëse më pas flenë në shtratin e tij.

Lejohet prezenca e grave në namazin e teravive nëse sigurohen nga fitneja (sprovat) me kusht që të dalin duke u kujdesur për rregullat islame të veshjes, e jo të zhveshura a të parfumuara.

KAPITULLI VI

Sadakatul-fitri

Sadakatul-fitri është obligim të cilin e ka obliguar i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) ditën e Bajramit të Ramazanit.

Abdullah b. Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me ta) thotë: *“I Dërguari i Allahut e ka bërë obligim sadaktul Fitrin në Ramazan për: Robin dhe të lirin, mashkullin dhe femrën, të voglin dhe të madhin, prej myslimanëve.”*

Ebu Seid El Hudrij (Allahu qoftë i kënaqur thotë): *“Në kohën e Pejgamberit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) e kemi dhënë sadakatul-fitrin ditën e Bajramit para se të falej ai,*

një Sa' ushqim, e ushqimi ynë ishte elbi, rrushi i terur, djathi dhe hurmat.”
(Buhariu)

Sadakatul-fitri nuk vlen nëse jepet në para, qilima, tesha, ushqime të kafshëve apo mallra e të ngjashme, ngase kjo është në kundërshtim me atë që ka urdhëruar Pejgamberi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Pejgamberi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: *“Ai që vepron diçka që është në kundërshtim me çështjen tonë, ajo i refuzohet atij.”*

E sasia e Sa'it është dy kilogramë e dyzetë gramë prej grurit të mirë e ky është Sa'i me të cilin e ka matur Pejgamberi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) sadakatul-fitrin.

Sadakatul-fitri duhet dhënë para namazit të Bajramit. Më mirë është të jepet para namazit ditën e Bajramit por, lejohet të jepet para tij vetëm një apo dy ditë.

Pas namazit të Bajramit nuk pranohet për shkak të hadithit të Ibn Abasit (Allahu qoftë i kënaqur me ta) i cili ka thënë: *“Pejgamberi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) e ka obliguar sadakatul-fitrin si pastrim prej fjalëve dhe veprave të kota dhe ushqim për të varfëritë. Ai që e jep para namazit atij i pranohet si sadaka e Fitrit e nëse e jep pas namazit atëherë është sadaka (lëmoshë) prej sadakave.”*

Por, nëse nuk e merr vesh për Bajramin vetëm se pas namazit apo gjatë kohës së dhënies së saj është në ndonjë vend

ku nuk gjendet askush që e meriton atë,
atëherë i mjafton ta jep atë pas namazit
kur t'i jepet mundësia.

Allahu e dinë më së miri dhe paqja e
bekimet qofshin për peygamberin tonë
Muhamedin, familjen dhe shokët e tij.